VENDIM
Nr. 680, datë 15.10.2014

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. MARGARITA QIRKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar dhe në vijim të vendimit nr. 1, datë 8.1.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Margarita Qirko, në vlerën 3 100 000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama